



Kodi i Sjelljes i Statkraft

Përmbajtja

Mesazh nga Presidenti dhe CEO	3
Pjesa I: Kuptimi dhe zbatimi i Kodit	
1. Angazhimi i Statkraft	4
2. Qëllimi i zbatimit	4
3. Ligjet e zbatueshme	4
4. Përgjegjësia personale	5
5. Përgjegjësia menaxhuese	5
6. Përmirësimi i vazhdueshëm	5
Pjesa II: Të vepruarit me integritet të biznesit	
1. Qëndrueshmëria	6
2. Klima	6
3. Mjedisi	6
4. Statkraft kërkon të balancojë me kujdes të dyja klimat, aspektin shoqëror dhe mjedisor. Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e punës ...	6
5. Barazia, diversiteti dhe respekti	7
6. Shëndeti, siguria dhe mbrojtja ...	7
7. Antikorrupsioni	7
8. Mirësjellja ndaj biznesit, dhuratat, mikpritja dhe shpenzimet	7
9. Partnerët e biznesit	8
10. Sanksionet	8
11. Konkurrenca e ndershme	8
12. Saktësia e regjistrimeve	8
13. Pastrimi i parave	8
14. Konfidencialiteti	9
15. Komunikimi	9
16. Konflikti i interesit	9
17. Kontributet dhe aktivitetet politike	9
18. Mbrojtja e pronës dhe pasurisë ..	10
19. Sistemet e informacionit dhe të TI	10
20. Substancat intoksikuese	10
21. Blerja e shërbimeve seksuale ..	10
Pjesa III: Trajtimi i rasteve të dyshimit dhe shkeljes së rregullave	
1. Ku të kërkonti këshilla	11
2. Ku t'i raportojmë shqetësimet apo shkeljet e rregullave	11
3. Pasojat e shkeljeve	11
Mohimi i përgjegjësisë	11

Mesazh nga Presidenti dhe CEO

Sjellja në mënyrë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme e biznesit ka qenë një shtyllë për Statkraft për më tepër se 120 vjet dhe vazhdon t'i karakterizojë aktivitetet tona në të gjitha tregjet kur jemi të pranishëm. Duke siguruar energji të pastër, ne kontribuojmë në mënyrë të konsiderueshme në adresimin e sfidave të shfaqura nga ndryshimi i klimës dhe në krijimin e bazës për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik. Unë jam i bindur se vlerat tona – kompetentë, të përgjegjshëm dhe novatorë – së bashku me këtë Kod të Sjelljes, tregojnë se ne jemi të pozicionuar mirë për detyrën. Kërkesat e qarta dhe sjellja e qëndrueshme e biznesit krijojnë besimin dhe besnikërinë midis punonjësve, partnerëve të biznesit, klientëve dhe komuniteteve. Në këtë mënyrë, ne do të vazhdojmë të jemi partneri i preferuar.

Kujdesi për njerëzit është në thelbin e kulturës së kompanisë tonë dhe çdokush duhet të jetë në gjendje të kthehet në shtëpi në mënyrë të sigurt nga puna në Statkraft. Unë besoj se kjo është e mundur nëse të gjitha ata që punojnë për Statkraft janë të angazhuar për sigurinë dhe menaxherët, duke filluar nga vetja ime, marrin një përgjegjësi të veçantë për të dhënë tonin e duhur në këtë fushë.

Angazhimi ynë themelor për integritetin e biznesit përshkruhet në Kodin e Sjelljes dhe përcakton pritshmëritë nga punonjësit e Statkraft si dhe nga partnerët tanë të biznesit. Unë pres që menaxherët të tregojnë angazhim dhe t'i japin tonin kulturës së kompanisë tonë. I inkurajoj gjithashtu të gjithë të tjerët që të bëjnë diskutime aktive dhe të hapura lidhur me sfidat e integritetit të biznesit.

Në Statkraft, ne i japim përparësi integritetit të biznesit dhe do t'i japim mbështetje të plotë punonjësve të cilët ngrenë çështje në këtë fushë. Integriteti i biznesit në praktikë varet nga të gjithë ne, kudo në botë, çdo ditë. Prandaj pres nga ju të gjithë që të jetoni me këtë Kod në punën tonë.

Ky version i Kodit të Sjelljes i Statkraft është miratuar nga Bordi i Drejtorëve në datën 26.06.2019.

→ KUPTIMI DHE ZBATIMI I KODIT

TË VEPRUARIT ME INTEGRITET TË BIZNESIT
TRAJTIMI I RASTEVE TË DYSHIMIT DHE SHKELJES SË RREGULLAVE

Pjesa I: Kuptimi dhe zbatimi i Kodit

1. Angazhimi i Statkraft

Vizioni i Statkraft është 'providing pure energy'. Kodi i Sjelljes së Statkraft (Kodi) na drejton në punën tonë për të siguruar energji të pastër dhe të përballueshme. Kodi përmban përkushtimin tonë themelor për të vepruar në mënyrë të qëndrueshme, etike dhe me përgjegjësi shoqërore dhe për t'iu përgjigjur të gjitha kërkesave ligjore në fuqi kudo që operojmë. Parimet e gjendura në këtë Kod përfaqësojnë një përmbledhje të pjesëve të rëndësishme të dokumenteve që drejtojnë Statkraft.

2. Qëllimi i zbatimit

Kodi zbatohet për të gjitha kompanitë e Statkraft Group dhe të gjithë individët të cilët punojnë për Statkraft, pavarësisht vendndodhjes. Kjo përfshin punonjësit e të gjitha niveleve, anëtarët e bordit, personelin e punësuar, konsulentët dhe të tjerët të cilët veprojnë në emër të Statkraft apo e përfaqësojnë atë.

Statkraft nuk mundet t'i arrijë objektivat e veta të biznesit pa partnerët e sipërmarrjeve të përbashkëta, furnitorët, kontraktuesit, konsulentët, palët në shkrirjet e bizneseve dhe blerjet apo klientët. Partnerët e biznesit priten që t'i përmbahen standardeve të cilat janë në përputhje me kërkesat etike të Statkraft.

3. Ligjet e zbatueshme

Statkraft bën biznes në shkallë globale. Si entitet norvegjez, Statkraft pajtohet me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme norvegjeze, si dhe me ligjet dhe rregulloret përkatëse të shteteve në të cilat ne operojmë.

KUPTIMI DHE ZBATIMI I KODIT ←

TË VEPRUARIT ME INTEGRITET TË BIZNESIT
TRAJTIMI I RASTEVE TË DYSHIMIT DHE SHKELJES SË RREGULLAVE

Gjatë hartimit të politikave tona, Statkraft gjithashtu merr udhëzime nga konventat dhe udhëzimet ndërkombëtare përkatëse, përfshirë ato të Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim.

Kur ekzistojnë dallime midis ligjeve në fuqi, rregulloreve dhe politikave të Statkraft, ne ndjekim standardin më të lartë.

4. Përgjegjësia personale

Ne duhet të sigurohemi që i njohim mirë dhe i kryejmë detyrat tona në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kod dhe ligjet e rregulloret e zbatueshme. Nëse jemi të pasigurt për kuptimin e ndonjë pjese të Kodit apo përballemi me një dilemë etike, duhet të kërkojmë këshilla dhe t'ia ngremë këtë çështje menaxherit tonë.

5. Përgjegjësia menaxhuese

Nga menaxherët pritet që të tregojnë angazhim dhe t'i japin tonin kulturës së kompanisë tonë. Ata duhet të sigurojnë që të gjitha aktivitetet brenda fushës së përgjegjësisë së tyre të kryhen në përputhje me kërkesat përkatëse dhe me këtë Kod. Menaxherët janë përgjegjës për sjelljen e tyre të biznesit, si dhe për punonjësit në varësi.

6. Përmirësimi i vazhdueshëm

Ne fokusohemi vazhdimisht te përmirësimi dhe novacioni. Menaxhimi aktiv i riskut dhe kontrolli i brendshëm janë pjesë integrale e të gjitha aktiviteteve të biznesit.

KUPTIMI DHE ZBATIMI I KODIT

→ TË VEPRUARIT ME INTEGRITET TË BIZNESIT

TRAJTIMI I RASTEVE TË DYSHIMIT DHE SHKELJES SË RREGULLAVE

Pjesa II: Të vepruarit me integritet të biznesit

1. Qëndrueshmëria

Statkraft operon në mënyrë të qëndrueshme dhe i zhvillon aktivitetet e saj në mënyrë që t'i shtojë vlerë aksionarëve të saj dhe shteteve e komuniteteve lokale në të cilat ne operojmë. Ne kërkojmë që të vendosim një dialog të rregullt e të hapur për çështjet e qëndrueshmërisë me komunitetet pritëse dhe palët e tjera të interesuara.

2. Klima

Statkraft siguron energji të pastër dhe kontribuon nëpërmjet aktiviteteve tona në kalimin drejt një klime më miqësore dhe një sistemi të energjisë së qëndrueshme. Ne kërkojmë vazhdimisht që të ruajmë një ndikim të ulët mbi klimën.

3. Mjedisi

Ne punojmë për të zvogëluar ndikimin tonë në mjedis dhe mbështesim një qasje paraprake ndaj sfidave mjedisore, përfshirë vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e rrezikut. Ne ndërmarrim nisma për të promovuar një përgjegjësi më të madhe mjedisore dhe për të inkurajuar zhvillimin dhe shpërndarjen e teknologjive miqësore ne mjedis.

4. Statkraft kërkon të balancojë me kujdes të dyja klimat, aspektin shoqëror dhe mjedisor. Të drejtat e njeriut dhe të drejtat e punës

Statkraft mbështet dhe respekton, brenda sferës së saj të ndikimit, mbrojtjen e të drejtave të njeriut të shpallura ndërkombëtarisht dhe siguron se nuk përkrah abuzimet në lidhje me të drejtat e njeriut. Ne gjithashtu mbështesim dhe respektojmë të drejtat e punës të njohura ndërkombëtarisht, duke përfshirë lirinë për t'u anëtarësuar dhe njohjen efektive të së drejtës për negociimin kolektiv, eliminimin e të gjitha formave të

punës me forcë dhe punës së detyruar, ndalimin efektiv të punës së fëmijëve dhe eliminimin e diskriminimit në lidhje me punën dhe profesionin.

5. Barazia, diversiteti dhe respekti

Ne punojmë në mënyrë aktive që të krijojmë një mjedis pune të karakterizuar nga barazia, diversiteti dhe respekti i ndërsjelltë ku çdokush ka mundësinë që të kontribuojë në suksesin e biznesit dhe të realizojë potencialin e tij. Punonjësit apo individët e tjerë të përfshirë në aktivitetet e Statkraft do të përzgjidhen dhe trajtohen në mënyrë që të mos diskriminohen në lidhje me gjininë, racën, besimin fetar, moshën, paaftësinë, orientimin seksual, kombësinë, origjinën sociale apo etnike, opinionin politik, përkatësinë e unionit apo mbi ndonjë bazë tjetër. Ne nuk tolerojmë asnjë formë të diskriminimit apo ngacmimit në vendet tona të punës.

6. Shëndeti, siguria dhe mbrojtja

Kujdesi për njerëzit është në thelb të kulturës së Statkraft. Një mjedis pune i sigurt, i mbrojtur dhe i shëndetshëm ka rëndësi kolosale dhe kjo zbatohet kudo ku ne jemi. Ne punojmë vazhdimisht që të përmirësojmë performancën në drejtim të vizionit tonë për zero lëndime.

7. Antikorrupsioni

Statkraft nuk e toleron dhe punon kundër korrupsionit në të gjitha format e tij në sektorin publik dhe privat. Ne nuk ofrojmë, japim, pranojmë, kërkojmë apo marrim ryshfete apo avantazhe jo të duhura, si në mënyrë direkte ashtu dhe në mënyrë indirekte, për biznes apo përfitime private, si për veten ashtu dhe për të tjerët.

8. Mirësjellja ndaj biznesit, dhuratat, mikpritja dhe shpenzimet

Statkraft e ndalon ofrimin apo pranimin e mirësjelljes ndaj biznesit – dhuratave, mikpritjes, shpenzimeve apo ndonjë përfitim tjetër – kur ato mund të përbëjnë, apo duket sikur përbëjnë, një ndikim të tepruar. Përveç kësaj, mirësjellja ndaj biznesit mund të pranohet apo ofrohet vetëm kur ajo është modeste, si në drejtim të vlerës ashtu dhe të shpeshhtësisë, dhe nëse koha e vendi janë të përshtatshme.

KUPTIMI DHE ZBATIMI I KODIT

→ **TË VEPRUARIT ME INTEGRITET TË BIZNESIT**

TRAJTIMI I RASTEVE TË DYSHIMIT DHE SHKELJES SË RREGULLAVE

Ne tregojmë kujdes të veçantë kur mirësjellja ndaj biznesit përfshin zyrtarët publikë.

9. Partnerët e biznesit

Marrëveshjet midis bizneseve duhet të bëhen në formë të shkruar dhe të përshkruajnë marrëdhënien e vërtetë midis palëve. Kompensimet për të cilat është rënë dakord duhet të jenë në përpjesëtim me shërbimin e kryer, të kryhen kundrejt dokumentacionit përkatës dhe të gjykoohen në mënyrë të përshtatshme.

10. Sanksionet

Statkraft nuk bën biznes apo tregti me shtete, grupe, organizata apo individë ndaj të cilëve janë vendosur sanksione.

11. Konkurrenca e ndershme

Ne zbatojmë standarde të larta të etikës tregtare dhe konkurrojmë brenda kuadrit të punës së rregullave të konkurrencës në tregjet në të cilat operon Statkraft. Kjo zbatohet në lidhje me konkurrentët, furnitorët dhe klientët.

12. Saktësia e regjistrimeve

Ne jemi të angazhuar për transparencën, verifikueshmërinë dhe saktësinë e të gjithë tregtisë tonë, duke respektuar detyrimet tona për konfidencialitetin. I gjithë informacioni i kontabilitetit duhet të jetë i saktë, i regjistruar dhe i riprodhuar në përputhje me ligjet dhe rregulloret.

13. Pastrimi i parave

Ne nuk marrim pjesë në asnjë formë të pastrimit të parave dhe sigurohemi që transaksionet financiare në të cilat është pjesë Statkraft të mos përdoren për pastrimin e parave.

14. Konfidencialiteti

Ne jemi të angazhuar që të ruajmë dhe të mos keqpërdorim të gjithë informacionin konfidencial në zotërimin tonë, qoftë ky informacion që i përket Statkraft apo partnerëve të biznesit. I tillë informacion konfidencial mund të përfshijë informacionin në lidhje me sigurinë, individët, tregtar, çështje teknike apo kontraktuale dhe lloje të tjera të informacionit të mbrojtura me ligj. Detyra e konfidencialitetit vazhdon edhe pasi punësimi apo ndonjë marrëdhënie tjetër kontraktuale me Statkraft ka përfunduar.

15. Komunikimi

Ne i sigurojmë informacion dhe komunikojmë me të gjitha palët e interesuara në mënyrë të hapur, të saktë dhe në kohën e duhur. Ndërsa respekton detyrimet e saj të konfidencialitetit, Statkraft i përgjigjet kërkesave të jashtme me informacion të bazuar në fakte.

16. Konflikti i interesit

Ne i shmangim situatat që çojnë në konflikt interesi midis individëve, interesit privat dhe interesit të Statkraft, ose që mund të kenë në një farë mënyre efekt negativ në lirinë tonë të veprimit dhe gjykimit.

Është gjithmonë në interesin e Statkraft që punonjësit të ngrenë çështjet etike.

17. Kontributet dhe aktivitetet politike

Statkraft nuk i sponsorizon partitë politike apo politikanët. Statkraft mund të marrë pjesë në debatin publik kur kjo është në interesin e Grupit.

Të gjithë ata të cilët punojnë për Statkraft, veprojnë në emër të saj apo e përfaqësojnë atë, janë të lirë që të marrin pjesë në aktivitetet politike demokratike, por kjo duhet të jetë pa referimin apo lidhjen e marrëdhënies së tyre me Statkraft.

KUPTIMI DHE ZBATIMI I KODIT

→ TË VEPRUARIT ME INTEGRITET TË BIZNESIT

TRAJTIMI I RASTEVE TË DYSHIMIT DHE SHKELJES SË RREGULLAVE

18. Mbrojtja e pronës dhe pasurisë

Ne jemi përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin në mënyrën e duhur të pasurisë së Statkraft. Pasuria e Statkraft nuk duhet të përdoret për përfitim personal.

19. Sistemet e informacionit dhe të TI

Ne marrim dhe përdorim informacionin, sistemet e TI dhe internetin në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale.

Informacioni i krijuar dhe i ruajtur në sistemet e TI të Statkraft konsiderohet pronë e Statkraft. Prandaj, Statkraft rezervon të drejtën e qasjes së të gjitha informacioneve të tilla përveçse kur kjo kufizohet nga ligji apo marrëveshja,

20. Substancat intoksikuese

Ndërsa punojmë për Statkraft, ne nuk na lejohej që të jemi nën ndikimin e substancave intoksikuese, duke përfshirë alkoolin dhe drogën.

Sasi të kufizuara të alkoolit mund të shërbejnë kur zakonet lokale dhe rasti e bëjnë këtë të përshtatshme, me kusht që konsumi të mos kombinohet me punën në makineri, ngarjen e makinës apo ndonjë aktivitet tjetër të papajtueshëm me përdorimin e alkoolit.

21. Blerja e shërbimeve seksuale

Statkraft mbështet ndalimin e blerjes së shërbimeve seksuale. Nuk duhet të blihen shërbime seksuale gjatë detyrës apo udhëtimeve të biznesit për Statkraft.

Pjesa III: Trajtimi i rasteve të dyshimit dhe shkeljes së rregullave

1. Ku të kërkonti këshilla

Nëse ndonjë punonjës i Statkraft është apo bëhet i pasigurt për kuptimin e ndonjë pjese të Kodit apo për rrugën e duhur të veprimit në përputhje me të, punonjësi në fjalë duhet të kërkojë këshilla dhe ta ngrejë çështjen te menaxheri i tij. Punonjësi mund të kontaktojë gjithashtu me Njësinë e Përgjegjshmërisë së Korporatës (email: compliancehelpline@statkraft.com; telefon: +4724067000).

2. Ku t'i raportojmë shqetësimet apo shkeljet e rregullave

Nëse një punonjës i Statkraft dyshon se një vendim apo veprim do të dhunojë apo dhunon angazhimin ligjor dhe etik të Statkraft, ai ka të drejtën dhe përgjegjësinë që ta ngrejë çështjen. Ai duhet të kontaktojë menjëherë me menaxherin e tij. Kur kjo nuk është e mundur apo është e vështirë, ai duhet të kontaktojë me Drejtorin e Auditit të Korporatës.

Të gjitha raportimet do të trajtohen si informacione konfidenciale. Raportimi mund të bëhet në mënyrë anonime te Kanali i Raportimit të Shkeljeve i menaxhuar nga Drejtori i Auditit të Korporatës (<https://statkraft.whistleblownetwork.net>). Në mënyrë alternative, me email ose telefon drejtpërdrejt me Drejtorin e Auditit të Korporatës (email: compliance@statkraft.com; telefon: +47 24 06 86 76; adresa: Statkraft AS, Drejtori i Auditit të Korporatës, Kutia Postare 200 Lilleaker, NO-0216 Oslo, Norvegji).

Shqetësimet mund t'i raportojnë gjithashtu edhe palët e jashtme.

Statkraft nuk do të përdorë asnjë formë hakmarrjeje kundër personave që ngrenë apo ndihmojnë në adresimin e një shqetësimi të sinqertë për integritetin e biznesit.

3. Pasojat e shkeljeve

Mos-respektimi i Kodit të Sjelljes së Statkraft shihet si çështje serioze e cila mund të çojë në veprime disiplinore apo pushimin nga puna dhe mund t'i raportohet autoriteteve përkatëse.

PROVIDING PURE ENERGY

OUR VALUES

Competent Using knowledge and experience to achieve ambitious goals and be recognised as a leader.

Responsible Creating value, while showing respect for employees, customers, the environment and society.

Innovative Thinking creatively, identifying opportunities and developing effective solutions.

